VENDIM
Nr.971, datë 1.12.2010

PËR DHËNIE FONDI PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS EMERGJENTE, TË KRIJUAR NË QARKUN E SHKODRËS, SI PASOJË E PËRMBYTJEVE NATYRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e një fondi, deri në kufirin prej 300 000 000 (treqind milionë) lekësh, për t'u përdorur nga Ministria e Brendshme, në programin buxhetor "Emergjenca civile", për përballimin e situatës emergjente, të krijuar nga përmbytjet natyrore. Ky fond klasifikohet si shpenzim nga të ardhurat jashtë limitit (kapitulli 6).
2. Fondi prej 300 000 000 (treqind milionë) lekësh mbulohet nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) dhe kalimi i tij, për llogari të Ministrisë së Brendshme, bëhet në bazë të shpenzimeve faktike, të kryera për përballimin e kësaj situate.
3. Njësitë vendore të qarkut të Shkodrës, në situatë emergjente, dhe objekti i përdorimit të këtij fondi, të përcaktohen nga Komiteti Ndërministror i Emergjencës Civile.
4. Kriteret dhe procedurat e përdorimit të këtij fondi të përcaktohen me një udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Brendshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha